



REPubLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 15949/Prot.

Tiranë, më 24.11.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Adresa: Rruga Abdi Toptani Nd.5, Tiranë

QENDRËS RES PUBLIKA

Z.Dorian Matlija

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd.24, H3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës Tuaj, nr. 1977/1 prot., datë 20.11.2023 të protokolluar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me nr. 15949 prot., datë 22.11.2023, "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", Ju informojmë si më poshtë:

Më datë 09.10.2023, Qendra "Res Publica", nëpërmjet postës elektronike "Kërkesë për informacion Nr. Prot 137/23", ka kërkuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, informacion si më poshtë:

1. Sa është numri i personave të proceduar për veprën penale "Shkelje të barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike", të parashikuara nga neni 258 i Kodit penal për periudhën 2018-2022?
2. Sa prej tyre kanë marrë dënim dhe sa prej tyre kanë marrë pafajsi?
3. Sa është numri i të proceduarve për këtë vepër penale nisur nga kallëzimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2018-2022?

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 19.12.2019 ka filluar funksionimin e saj, si organ kushtetues, referuar nenit 148, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke u organizuar dhe funksionuar, si një organ me pavarësi institucionale, mbi bazën e ligjit nr. 95/2016 "Për funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", i ndryshuar.

Prokuroria e Posaçme nuk ka patur asnjë qëllim për refuzim ose mosdhënie të informacionit në kohë, por nxjerrja e të dhënave statistikore të kërkuara nga Qendra "Res Publica" përkon

pikërisht në një periudhë shumë të ngarkuar me raportimet e kryera në disa Institucione të vendit dhe ndërkombëtare

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, në përmbushjen e misionit të posaçëm që ka institucioni jonë, lidhur me kërkesën për informacion të paraqitur, informojmë si më poshtë:

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në lidhje me informacionin e kërkuar nga gazetari Dorian Matllija, Drejtor i Qendrës “Res Publica” rezulton se:

- Gjatë periudhës 19.12.2019 - 2022, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka regjistruar gjithsej 88 persona nën hetim, për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i K.Penal.
- Në lidhje me kallëzimet e bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, nuk rezultojnë të ketë persona të regjistruar nën hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 258 K.Penal.
- Përsa i përket informacionit për numrin e të dënuarve në lidhje me këtë veprë penale, ju informojmë se mund t’i drejtoheni Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Prokuroria e Posaçme ka zbatuar me përpikmëri detyrimet që rrjedhin nga neni 7, i ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, duke bërë publike në mënyrë korrekte, për aq sa është e mundur dhe lejon legjislacioni në fuqi, tek rubrika “Njoftim për shtyp” në faqen zyrtare, të regjistrimit të procedimeve penale, të veprës penale, si dhe informacione të tjera. Gjithashtu, në bazë të kërkesave specifike ka informuar publikun dhe kërkuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe legjislacionit specifik të prokurorisë.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin Dumani

